



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9/35 /2020
Data: 14.12.2020

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 17.11.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë Rini dhe Sport), Refet Kalisi Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Naser Laçi (Shef për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Bashkim Sopa (Zyrtarë për Transparencë), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plotësimi i Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak se Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
5. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi.
6. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell, nga drejtorja për arsim kemi edhe një material shtesë të cilin ua kemi dërguar, shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollor, Hani i Elezit. Për pikën shtesë të cilën e kemi përcjell hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedhe në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plotësimi i Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak se Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përkuajtshjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
5. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi.
6. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
7. Shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollor, Hani i Elezit.
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plotësimi i Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- ndryshimi i këtij komiteti vjen nga anëtarët e LDK-së dhe duhet të kalon edhe në komitet për politik e financa dhe të miratohet në kuvend. Në vend të znj.Hanumshahe Dibranit zëvendësohet znj.Samire Curri. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLOTËSIMI I KOMITETIT PËR KOMUNITETE SI KOMITET OBLIGATIV NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak se Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- asociacioni i komunave po i harton bashkarishtë rregulloret dhe kjo është një rregullore që rregullohet mënyra forma e dhënies në shfrytëzim të paluajtshmërive të komunës për një afat më pak se një vit. Rregullorja është e bazuar në ligj dhe në udhëzime administrative që në bazë të kësaj rregullore përcaktohet kushtet dhe kriteret për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Neni pesë e sqaron më saktësisht se cilat prona komuna mund të i jep në shfrytëzim. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje dhe sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- kërkoj sqarim për nenin gjashtëmbëdhjetë që është hijezuar me ngjyrë. Rregullorja e përcakton më pak se një vit dhe është mirë që të rregullohet kjo. Kërkoj sqarim te prishja e kontratës nëse bëhet në mënyrë të një anshme në bazë të cilave kriteret bëhet.

Nexhmedin Daci thekson:- këtu paraqiten për ata të cilat janë dhënë viteve të më hershme me karakter të përkohshëm dhe për çdo vit bëjmë kontrata dhe kështu e kemi trashëguar edhe më herët prej komunës së Kaçanikut, nuk mund të bëhet kontratë më shumë se një vit se ndoshta mund të realizohet ndonjë projekt kapital nga komuna. Ata të cilat nuk i kryejnë obligimet e qirasë nuk u vazhdohet kontrata. Kjo rregullore është model për të gjitha komunat por edhe zyrtari ligjorë ishte në pajtim që të jetë më pak se dymbëdhjetë muaj. Sa i përket prishjes së kontratës është e rregulluar me nenin 14 (katërbëdhjetë) pika 2 (dy), në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilën është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatis raport përfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.

Teuta Shkreta thekson:- cilat prona janë komunale në Han të Elezit. A keni ndonjë projekt për vitet e ardhshme.

Nexhmedin Daci thekson:-janë disa shitore që janë në pronë të komunës të cilat janë rreth rrugës. Kjo zonë është e rregullime planë zhvillimorë urbanë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA DRAFT RREGULLORJA PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Naser Laçi thekson:- si drejtori e kemi pasur një rregullore më herët por nevojat e kanë shtyjtë që të hartohet kjo rregullore. Ne e kemi paraqitur një draft në komitet për politik e financa për shkak se më herët ishin disa forma që i kemi bërë përmes qendrës për punë sociale por kemi vërejtur që kanë munguar do mekanizma që është dashur me i shtyjtë në lëvizje duke filluar prej shkollës shëndetësisë, policisë, qendrës për punë sociale. Në këtë draft rregullore janë paraparë dhe besoj që do të jenë më funksionale. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- plotësimi ndryshimi i kësaj draft rregullore vjen për shkak të ndryshimit të ligjit për të drejtat e fëmijëve. Rregullorja që është paraqitur është njëjtë edhe me të komunave të tjera të Republikës së Kosovës.

Teuta Shkreta thekson:- në komunën tonë sa është numri i fëmijëve të cilët janë pa përkujdesje.

Naser Laçi thekson:- këtë informacion nuk e kam por ndoshta për mbledhje të kuvendit të komunës mundem me ua përcjell.

Mehmet Ballazhi thekson:- është një rregullore që nuk kishim mundur me i dal zot shumë duke i parë në përditshmëri, e që rast konkret e kemi të kufiri për të cilin kemi diskutuar disa herë. Në këtë rregullore ka shumë pika që i referohen mbrojtjes së fëmijëve, sigurisë së fëmijëve, mbarëvajtjes së jetës së tyre për me qenë të barabartë me fëmijët e tjerë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA DRAFT RREGULLORJA PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Naser Laçi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Mallzum Qajani thekson:- në këto dy muaj kemi një shtim të numrit të rasteve me koronavirusë e që në dy javët e fundit kemi pasur shtim pak më të madh. Rasti maksimal i banorëve të komunës me koronavirus që kanë qenë për një herë është 15. Kemi qenë në zonën e verdhë siç dihet që Ministria e Shëndetësisë i ka përcaktuar me numër të të infektuarve brenda pesë dite. Një pjesë e madhe dje kanë dal që janë të shëruar dhe për momentin i kemi vetëm shtatë të cilët janë aktiv.

Teuta Shkreta thekson:- pse nuk i bëjnë teste qytetarët sepse ka raste që janë të sëmur dhe hezitojnë me i bërë testet.

Sabedin Hasallari thekson:- a ka gjasa me filluar me i bërë testet edhe komuna jonë.

Mallzum Qajani thekson:- besojë që shumë shpejtë do të jemi gati me filluar sepse kemi pas probleme me punëtoren e cila i bënë analizat për shkak se ka qenë me koronavirus.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:-materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollor, Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- është dërguar si material shtesë por arsyeja ishte që me pasur gati për përzgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollor, Hani i Elezit. Propozimi është hartuar në harmoni me udhëzimin administrativ.

Mehmet Ballazhi thekson:- komisioni a është formal si komision. Te këshilli i prindërve si është përzgjedhur anëtari.

Menduh Vlasi thekson:- komisioni duhet të miratohet në kuvend. Këshilli i prindërve i ka kryer procedurat dhe e ka dërguar një emër.

8. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:42

Procesmbajtësi
Avni Bushi

